



Datë: 27.05.2025

Numër Protokolli: 4812/2025

A.nr.636/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.636/2025, të datës 11.04.2025, të parashtruar nga ankuesi R.G, kundër Vendimit KD.nr.01/2025, të datës 06.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16, paragrafi, 3 dhe nenin 18 paragrafi 1, nën paragrafin, 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 27.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.636/2025, e datës 11.04.2025, e parashtruar nga ankuesi R.G.

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.nr.01/2025, i datës 06.03.2025, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil R.G (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 10.04.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (e regjistruar më datë 11.04.2025 dhe nën shenjën A.nr.636/2025), kundër Vendimit KD.nr.01/2025, të datës 06.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke kontestuar ligjshmërinë e këtij akti administrativ.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës (*tutje referuar SHKK*), ndërsa, ky i fundit më datë 24.04.2025, ka përcjell provat lidhur me çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të LPPA-së, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2392/2025, të datës 11.04.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 20.12.2024, nga ankuesi për Shefin për Siguri në SHKK; Kopjen e ID-së së ankuesit; E-mailin e datës 10.04.2025 të ankuesit për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën për

përgjigje në ankesë të datës 16.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 24.04.2025; Njoftimin për kërkesën e ankuesit e datës 22.04.2025; Deklaratën e datës 23.04.2025 të zyrtarit N.Z; Deklaratën e datës 22.04.2025 të zyrtarit E.Sh; Formularin e pranimit, në vendin e punës të datës 11.01.2025; Fotot nga incizimi i kamerave datës 11.01.2025; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, të datës 17.01.2025; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 01.08.2019; Vendimin KD.nr.01/2025, të datës 06.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Zarfën e datës 07.03.2025; Flete kthesë e datës 13.03.2025; Procesverbal i datës 18.02.2025 i Komisionit Disiplinor; Ftesë për intervistë e datës 14.02.2025; Raporti hetimor i Panelit Disiplinor i datës 17.01.2025; Vendimin e datës 13.01.2025 për themelim të Panelit Disiplinor; Raporti iniciues disiplinor i datës 13.01.2025 nga A.S; Deklaratë nga i paraburgosuri B.B e datës 13.01.2025; Shkresë për gjetjen e mjetit të palejuar i datës 13.01.2025; Raporti 12 orësh i kujdestarisë datë 11.01.2025; Deklaratën e datës 14.01.2025 të ankuesit; Deklaratën e datës 14.01.2025 të F.K; Deklaratën e datës 14.01.2025 të M.M; Deklaratën e datës 14.01.2025 të I.M; Deklaratën e datës 17.01.2025 të A.S; Formularin e pranimit i datës 11.01.2025; Urdhëresë për pranim në paraburgim PPR:2025/004414 të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik; Formuari i datës 11.01.2025 për gjësendet e të paraburgosurit në kohën e pranimit; Forma për bastisje dhe higjienë gjatë procedurës së pranimit të datës 11.01.2025; Formularin për intervistën pranuese me të burgosurin datës 11.01.2025; Aktvendimin PPR:2025:004414 i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik; Kërkesë për lejimin e kontaktit telefoni me familje forma 2.1.9; Formularin për vlerësimin e faktorëve të rrezikut për vetëvrasje Forma Nr. 2.1.19 e datës 11.01.2025; Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikëqyrës të Lartë; Shkresë për Kontroll ditor, shëtitore, Tunelet dhe detektorët të datës 11.01.2025; Emailin e datës 15.01.2025 për B.C; Emailin e datës 13.01.2025 nga B.C për L.A; Foto e mjetit të gjetur thikës me këllëf; Deklaratën e datës 13.01.2025 nga B.B; Deklaratën e datës 17.01.2025 nga S.T.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga provat e lëndës rezultojnë:

-Ankuesi është i punësuar Shërbimin Korrektues të Kosovës (tutje SHKK), dhe se i njëjti ushtron pozitën e punës: Mbikëqyrës i lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

-Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, më datë 13.01.2025, ka themeluar Panelin Disiplinor ad hoc për hetimin e rastit HD-01/2025, të datës 13.01.2025, lidhur me gjetjen e mjetit të rrezikshëm (thikë më këllëf) të i paraburgosuri B.B.

- Më datë 17.01.2025, Paneli Disiplinor pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore lidhur me rastin konkret ka nxjerr raportin hetimor, më konstatimet se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (mos përmbushje e detyrave të punës), nenin 58, paragrafi 3, nën paragrafi 3.11 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, (mos veprim dhe lenie pas dore të detyrave të punës) dhe nenin 5, paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 dhe 3.11 të Udhëzimit Administrativ MD.16/2024 për Procedurën dhe Shqiptimin e Masave Disiplinore për Personelit e SHKK-së.

- U.d Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, bazuar në raportin e Panelit Disiplinor, më datë 17.01.2025, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, nën dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 58, paragrafi 3, nën paragrafi 3.4 dhe 3.11 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektuar të Kosovës dhe nenin 5, paragrafi 3, nën paragrafi 3.4 (shkelje serioze të rregullave të sigurisë) dhe

3.11(mos veprim dhe lenie pas dore të detyrave të punës) të Udhëzimit Administrativ MD.16/2024 për Procedurën dhe Shqiptimin e Masave Disiplinore për Personelit e SHKK-së.

-Komisioni Disiplinor i SHKK-së, më Vendimin KD.nr.01/2025, të datës 06.03.2025, ka shpallur ankuesin përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të paraparë me nenin 58, paragrafi 3 nën paragrafi 3.4, 3.11 dhe 3.12 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalim njëzet përqind (20%) e pagës bazë për një periudhë një (1) mujore*”.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimi KD.nr.01/2025, të datës 06.03.2023, të Komisionit Disiplinor të SHKK-së (të pranuar më datë 13.03.2025) më pretendimet së përkundër mungesës së stafit ka përmbushur të gjitha detyrat, pasi që në ditën kritike kishte angazhuar dy zyrtarë për bastisjen e të paraburgosurit B.B dhe se deri në ditën kritike Qendra e Paraburgimit në Gjilan nuk ka poseduar detektorë në zyrën e pranimit. Shton, së thika të i paraburgosur B.B është gjetur pas dy ditësh. Kërkon, që ankesa të aprovohet, të shfuqizohet vendimi i kontestuar apo çështja të kthehet në rivlerësim.

Në kuptim të kompetencës së Këshillit në pikëpamje materiale, Kolegji i’u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 6, ku përcaktohet se : “*1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t’i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë..” dhe si rrjedhojë referuar këtij përcaktimi ligjor rezultoi fakti se të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë statusin e veçantë të nëpunësit civil, dhe se ligj të veçantë mund të rregullohet ndryshe dhe në mënyra të veçantë procedura disiplinore e nëpunësve civil të këtij institucione si dhe të përcaktohen shkelje dhe masa disiplinore tjera nga ato të përcaktuar me ligjin bazik për zyrtarët publik.*

Rrjedhimisht, nisur nga konstatimi si me sipër, Kolegji i Këshillit në trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, si ligj i veçantë, gjegjësisht: nenin 58 ku përcakton se: “*1. Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publik, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta...3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.1.vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve zyrtare; 3.2. dëmtimi i pronës; 3.3 .ardhja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të substancave narkotike, ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës; 3.4. shkeljet serioze e rregullave të sigurisë; 3.5. zbulimi i të dhënave apo informatave konfidenciale; 3.6. jep deklarata publike për Shërbimin Korrektues, pa autorizim të Drejtorit Përgjithshëm; 3.7. shfrytëzon në mënyrë të palejuar titullin apo autoritetin e tij për përfitim personal; 3.8. jep informata për të burgosurit pa autorizim; 3.9. ngacmimit seksual i ndonjë të burgosuri, të punësuarit apo vizitorit; 3.10. diskriminimi në çfarëdo forme ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundër të burgosurve, zyrtarëve ose të punësuarve tjerë; 3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues; 3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës; 3.13. me vetëdije apo me pakujdesi lëshon ose nënshkruan deklaratë të rremë në lidhje me përmbushjen e detyrës; 3.14. duke*

qenë përgjegjës, apo person me autoritet, injoron apo nuk ndërmerr masa kur një punonjës shkelë rregullat dhe detyrat e punës; 3.15. nuk i raporton autoritetet më të larta mbi çdo mall kontrabandë që zbulon tek ndonjë punonjës, i burgosur apo anëtar tjetër të publikut; 3.16. nga pakujdesia rrezikon ose shkakton dëme fizike apo vdekjen e ndonjë te burgosurit punonjësi tjetër të Shërbimit apo personi tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi; 3.17. përdorë forcën e cila nuk është e kufizuar në intensitetin dhe zgjatjen e saj deri në atë masë që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim; 3.18. përdorë mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e Shërbimit Korrektues; 3.19. lejon ose mundëson arratisjen e ndonjë të burgosuri; 3.20. nuk ndërmerr masat e duhura, që ka, kur ndonjë i burgosur shkelë rregulla e brendshme, sulmon një punëtor, të burgosur tjetër, ose anëtarë të publikut; 3.21. nuk jep llogari, mban pa vend, dhe keqpërdorë të hollat e pronën e publikut apo të hollat/pronën e çdo personi tjetër që i bien në dorë gjatë kryerjes së detyrës së tij; 3.22. flenë gjatë orarit të punës; 3.23. detyron, nxit apo përpiqet që me çdo kusht të detyrojë një punonjës tjetër të marrë pjesë në punë ilegale apo të palejuar, apo në shkeljen e standardeve të etikës profesionale; 3.24. nuk bën raportimin të menjëhershëm të një incidenti në institucion; Përleshet me punëtorët tjerë të Shërbimit apo ndonjë anëtar tjetër të publikut gjatë detyrës; 3.25. fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sende të pa lejuara; 3.26. nuk raporton te zyrtarët kompetent, rastet e keqtrajtimit të të burgosurve nga ana e punëtorëve tjerë; 3.27. nuk raporton dhe nuk merr masa ndaj shkeljeve nga të burgosurit, konform dispozitave ligjore; 3.28. fsheh, mban, injoron, dëmton apo asgjëson ndonjë ankesë apo raport të bërë kundër ndonjë zyrtari ose te burgosuri; 3.29. keqpërdorimi i armës zyrtare apo humbja e saj... si dhe nenin 59, i cili përcakton se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj personelit SHKK-së, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në katër dhjetë për qind (40%) e pagës për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 1.3. transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj; 1.4. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy(2) deri në pesë (5) vjet; 1.5. ulje në pozitë; 1.6. largimi nga shërbimi civil. 2. Procedura disiplinore zhvillohet në pajtim me ligjin për zyrtarët publikë. 3. Procedura dhe shqiptimi i masave disiplinore rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë..

Po ashtu Kolegji i Këshillit, i'u referua edhe Udhëzimit Administrativ MD.16/2024 për Procedurën dhe Shqiptimin e Masave Disiplinore për Personelit e SHKK-së, gjegjësisht nenit 5, paragrafi 1, paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 dhe 3.11, ku përcaktohet: 1. Përveç shkeljeve disiplinore të parapara në Ligjin për Zyrtar Publik, personeli i SHKK-së përgjigjet edhe për shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive të veçanta të përcaktuara në Ligjin përkatës për Shërbimin Korrektues të Kosovës. 3. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësive të veçanta janë: 3.1. vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve zyrtare; 3.2. dëmtimi i pronës; 3.3. ardhja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të substancave narkotike, ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës; 3.4. shkeljet serioze të rregullave të sigurisë; 3.5. zbulimi i të dhënave apo informatave konfidenciale; 3.6. jep deklarata publike për Shërbimin Korrektues pa autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm; 3.7. shfrytëzon në mënyrë të palejuar titullin apo autoritetin e tij për përfitim personal; 3.8. ofron informata për të burgosurit pa autorizim; 3.9. ngacmimit seksual i ndonjë të burgosuri, të punësuar apo vizitorit; 3.10. diskriminimi në çfarëdo forme ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundër të burgosurve, zyrtarëve ose të punësuarve tjerë; 3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues....

Kolegji i Këshillit referuar kuadrin ligjor si me sipër, ka analizuar aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje më provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni Disiplinor i SHKK-së lidhur me çështjen disiplinore të ankuesit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe mbi këtë bazë ka zbatuar drejtë ligjin material, sepse, nga analizimi i provave materiale rrjedh se ankuesi në detyrën e Mbikëqyrësit të Lartë, më datë 11.01.2025, ka qenë më orar pune nga 07:00-19:00, dhe po në këtë datë në orën 12:45 minuta, ishte pranuar i paraburgosuri me inicialet B.B,

ashtu që, i njëjti fillimisht ishte pranuar nga zyrtari OB6, ndërsa, zyrtari M.M të paraburgosurin e kishte dërguar tek Pavijoni, kurse sipas formularit Forma 2.1.4 (për Gjësendet e të Burgosurit në Kohën e Pranimit) të datës 11.01.2025, si gjësende të identifikuar më rastin e pranimit të të paraburgosurit B.B janë evidentuar Letërnjoftimi dhe Lidhëset e këpucëve. Rrjedhimisht, sipas konstatime të Panelit Disiplinor të dhënë në raportin hetimor të datës 17.02.2025, me futjen e të paraburgosurit në detektor, është ndezura drita e kuqe që sinjalizon se ka gjera të metalit, por që zyrtari M.M nuk ishte ndalur të kontrolloj sinjalizimin e as që të ri përsëris kontrollin e të paraburgosurit, por të njëjtin e dërgon në pavion. Ndërsa, pas pranimit nga zyrtari I. M, i cili të paraburgosurin e fut në dhomë pa e kontrolluar. Ndërsa, sipas dokumentit Forma 3.1.10 të datës 13.01.2025, të nënshkruar nga zyrtari korrektues A.S, rrjedh se më rastin e bastisjes së të paraburgosurit B.B është gjetur një thikë me këllëf, fakt ky i konfirmuar edhe nga vet i paraburgosuri, i cili në deklaratë e tij të datës 13.01.2025 ka pohuar se ka poseduar thikën, të cilën e ka pas edhe në kohën e arrestimit edhe gjatë hyrjes në Qendrën e Paraburgimit. Tutje, i paraburgosuri në deklaratat e tij kishte shtuar se: *thikën e ka pas në kohën e arrestimit, por që policia nuk ma kanë gjetur gjatë mbajtjes në 48 orë, kur kam ardh në burg me ka kontrolluar vetëm një person më dorë por nuk ka gjetur, dhe se edhe pse me ka pyetur unë nuk ju kam treguar për thikën. Gjatë hyrjes në pavijon ka bërë zhurme detektori por askush s'me ka thënë asgjë, dhe se pasi kam shkua ne krahun P-5 nuk me ka kontrollu askush.*

Rrjedhimisht, në kuptim të përgjegjësive së ankuesit lidhur me rastin kritik me emërtimi :” *gjetje e thikës me këllëf të i paraburgosuri B.B*”, Kolegji fillimisht thekson faktin e pa kontestuar së ankuesi më datë 11.01.2025, ka qenë në vendin e punës dhe atë me orar nga ora 07:00 deri në orën 19:00, kohë kjo gjatë së cilës edhe është bërë pranimi i të paraburgosurit B.B dhe së mbi bazën e detyrave edhe përgjegjësive si mbikëqyrës, ankuesi ka qenë i detyruar që në ditën e ngjarjes të mbikëqyrte dhe të udhëhiqte stafin-zyrtaret korrektues të pranishëm atë ditë në punë, ashtu që të siguronte zbatim të plotë të procedurave të kontrollit/bastisje së të paraburgosurve me rastin e pranimit, ndërsa, sipas provave të lëndës ankuesi kishte dështuar në ushtrim të përgjegjësive për faktin së përkundër që në formularët e plotësuar të gjësendeve personale rrjedh se me rastin e kontrollit nuk ishte gjetur ndonjë mjet i palejuar të i paraburgosuri B. B, pas bastisjes me datë 13.01.2025 pra pas dy ditëve tek i njëjti i paraburgosur është gjetur një thikë, mjet ky qe në ndërlidhje me nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr.10/20231 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, është mjet i palejuar. Ne kontest, të përgjegjësive së ankuesit si mbikëqyrës po ashtu Kolegji si fakt relevant mori parasysh edhe rrethanën se në ditën e pranimit të të paraburgosurit B.B, nuk ishin respektuar procedurat e kontrollit, sepse kontrolli i të paraburgosurit në fjalë si më rastin e pranimit ashtu edhe në dhomën e pranimit ishte bërë vetëm nga një zyrtar korrektues, ndërsa, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.10/20231 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese përcaktohet ” **3. Kontrollimi i të burgosurit bëhet nga dy zyrtarë në atë mënyrë në të cilën respektohet personaliteti dhe dinjteti i tij gjatë kontrollit duhet të jenë se paku dy zyrtare korrektues prezent.**

Bazuar në konstatimet dhe të gjeturat si me lartë, Kolegji erdhi në përfundim se në veprimet e ankuesit manifestohen të gjitha elementet e shkeljes disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafët 4.1 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 58, paragrafi 3, nën paragrafët 3.4, 3.11 dhe 3.12 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, kështu që, më të drejtë Komisioni Disiplinor ka shpallur përgjegjës ankuesin dhe ka shqiptuar masa disiplinore në proporcion më shkeljen e ndodhur.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi, rrejdhimisht, Kolegji vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, duke lenë në fuqi Vendimin KD.nr.01/2025 të datës 06.03.2025 të Komisionit Disiplinor të SHKK-së.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.636/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, R.G;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*